




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PARTESHIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Parteshit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Parteshit (Komunës së Parteshit), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Parteshit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Çështjet që kanë ndikuar në opinionin e auditimit janë si në vijim:

B1 Komuna nuk kishte regjistruar 241 hektar parcela komunale, vlerën e pasurive 4,540€ në regjistrin e pasuritë mbi 1,000€ në SIMFK. Po ashtu, pasuria me vlerë nën 1,000€ në PFV ishte prezantuar në vlerë 12,009€, e njëjta vlerë me dy vitet paraprake. Në PFV te anekset vlera e prezantuar ishte zero.

A1 Paraqitja e pasaktë dhe jo e plotë e informatave financiare dhe jo financiare në PFV-të.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Parteshit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Gjatë angazhimit tonë kemi gjetur se Komuna nuk ka vepruar në pajtueshmëri me autoritetet si:

- B2 Komuna kishte paguar me vonesë 10 pagesa në vlerë 58,852€ pas afatit të lejuar prej 30 ditësh.
- B3 Komuna gjatë vitit 2021 kishte angazhuar 37 zyrtarë për shërbime të veçanta. Ne analizuam pesë rastet të angazhimeve, të cilat ishin pas hyrjes në fuqi të ligjit për zyrtarët publik, dhe se ato ishin nënshkruar pa udhëhequr ndonjë procedurë të prokurimit siç kërkohet me ligjin për zyrtarët publik
- B4 Edhe përkundër rekomandimit nga vitit i kaluar, Komuna edhe pse kishte përgatitur një dokument për mbështetje financiare të OJQ-vë në vlerë 1,000€, si i tillë nuk ndërlidhet me pagesat e testuara për mbështetje financiare të OJQ-ve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Parteshit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Parteshit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Parteshit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Parteshit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Parteshit.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë të bëjnë me mos verifikimin e gjendjes së pronave, angazhimin e punonjësve jo përmes prokurimit, mungesa e planit vjetor për mbështetje financiare për OJQ, dobësive në menaxhimin e pasurive, dobësive në përgatitjen e PFV, të arkëtueshmeve si dhe vonesave në pagesa. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me shtatë rekomandime, prej tyre një rekomandim i ri dhe gjashtë të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Regjistri jo i plotë i pasurisë dhe mosfunksionimi i sistemit e-pasuria

Gjetja Neni 6, pika 3 i rregullores MF - nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se 'Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria'.

Bazuar në teste tona ne kemi vërejtur:

- Komuna nuk i ka të regjistruar 241 hektar të parcelave komunale;
- Një pagesë në vlerë 4,540.48€, pasuri mbi 1,000€ nuk ishte regjistruar në regjistrin SIMFK; dhe
- Pasuria me vlerë nën 1,000€ në PFV ishte prezantuar në vlerë 12,009€ të njëjtë vlerë me dy vitet paraprake. Në PFV te anekset vlera e prezentuar ishte zero.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunës sa i përket azhurnimit të regjistrit kontabël dhe menaxhimit të pasurisë.

Ndikimi Dobësitë e identifikuara në menaxhimin e pasurisë që kanë të bëjnë me mos regjistrimin e pasurive dhe dobësive në shpalosje ndikojnë në raportimin e informatave jo të sakta për pasurinë e komunës dhe vlerën e tyre në PFV.

Rekomandimi B1 Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të regjistruar të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Dobësitë në përgatitjen e Pasqyrave Financiare**Gjetja**

Sipas Rregullores së MF-së Nr. 01/2017 për raportimin financiar vjetor të organizatës buxhetore, është përcaktuar mënyra e përgatitjes së PFV e cila është në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik për Raportimin Financiar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme.

Gjatë rishikimi të PFV kemi identifikuar dobësitë si në vijim:

Neni 14.6 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit - te hyrjet

- Pjesa të hyrat, buxheti fillestar krahasuar me buxhetin final - të hyrat tatimore dhe jo tatimore janë prezantuar të hyrat e realizuara gjatë vitit në vlerë 132,000€, nuk është dashtë të prezantohen. Kjo pjesë ka të bëjë me të hyrat e planifikuara, planin fillestarë dhe rregullimet gjatë vitit (rritjet apo shkurtime të planifikimit);
- Po ashtu, në pjesën planifikimi për të hyrat është prezantuar në vlerë prej 158,000€ të hyrat nga donacionet, kjo vlerë është pranuar në vitet paraprake dhe i është ndarë Komunës si buxhet për shpenzime për vitin 2021;
- Neni 14.6 pjesa shpenzimet/pagesat, shpalosja apo krahasimi i ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit për shpenzime, rritja e buxhetit nga donacionet është prezantuar në vlerë 127,000€, është dashtë të jetë 157,614€; dhe
- Burim i financimit të tjera është prezantuar 29,000€, është dashtë të ishte 441€ (financim nga huamarrja).

Pjesa e Shpalosjeve

- Neni 20 - Raportet për avancet e pa arsyetuara, në Raportin Vjetor Financiarë janë prezantuar në vlerë prej 10,730€, është dashtë të prezantohen në vlerë prej 20,802€; dhe
- Neni 24 - Raportet e fondeve të donatorëve të pa shpenzuara, saldo për bartje ishte prezentuar 24,055, është dashur të jetë 30,788€.

Ndikimi

Paraqitja e pasaktë dhe jo e plotë e informatave financiare dhe jo financiare në PVF-të, ka ndikuar në pa saktësi të të dhënave dhe ulë shkallën e besueshmërisë së tyre.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të shtojë kontrollet gjatë përgatitjes së PVF-ve në mënyrë që shpalosjet në PVF për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e lëshuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar nuk duhet të nënshkruhet nëse nuk janë kryer të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PVF-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B2 - Vonesa në pagesa dhe shpenzimet gjyqësore/përmbartimore

- Gjetja** Sipas nenit 39.1 të Ligjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kërkohet që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës.
- Gjatë testimit, ne kemi vërejtur në 10 fatura në vlerë prej 58,852€, që faturat e nuk ishin paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat ishin prej 10 ditë deri në 20 muaj.
- Mos pagesa e faturave brenda afatit të paraparë ligjor ishte për shkak të mos-sigurimit të fondeve buxhetore për pagimin e shpenzimeve me kohë.
- Ndikimi** Vonesat në realizimin e pagesave mund të ndikojnë që Komuna të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore / përmbartimore për Komunën
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore, për të shmangur shpenzimet shtesë buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Angazhimi për shërbime të veçanta pa kryer procedurat adekuate ligjore

- Gjetja** Neni 84 i Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114 thekson se - Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave të KRPP-së për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent / kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit
- Komuna gjatë vitit 2021 kishte angazhuar 37 zyrtarë për shërbime të veçanta. Ne analizuam pesë rastet të angazhimeve, të cilat ishin pas hyrjes në fuqi të ligjit për zyrtarët publik, dhe se ato ishin nënshkruar pa udhëhequr ndonjë procedurë të prokurimit siç kërkohet me ligjin për zyrtarët publik.
- Sikurse është trajtuar edhe vitin e kaluar, kishte angazhime me marrëveshje për shërbime të veçanta për mbulimin e pozitave të rregullta.
- Sipas menaxhmentit kjo ishte pasojë e mungesës së pozitave të aprovuara në planifikimin e buxhetit.
- Ndikimi** Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitave për shërbime të veçanta, përveç mosrespektimit të procedurave ligjore po ashtu e rrit edhe rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyrat e caktuara, çka mund të reflektoj edhe në performancë e tyre në punë.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Dobësi në planin vjetor për mbështetje financiare për OJQ

Gjetja Rregullorja e MF - Nr. - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik Të OJQ-ve, Neni 6.1 përcakton se “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës”.

Edhe përkundër rekomandimit nga vitit i kaluar, Komuna ende nuk e kishte përgatitur Planin Vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, për të cilat ne kemi testuar tri pagesa në vlerë prej 10,648€.

Komuna kishte përgatitur një dokument për mbështetje në vlerë 1,000€, i cili nuk ndërlidhet me pagesat e testuara për mbështetje financiare të OJQ-ve.

Ndikimi Dobësitë në planin vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, paraqesin mungesë të informatave së cilat fusha do përkrahën nga Komuna, shumën e mjeteve financiare si dhe qëllimet se për çfarë janë të parapara këto mjete.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se Plani Vjetor për mbështetje financiare për OJQ-të të përgatitet për të gjitha fushat e mbështetjes dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për mbështetje financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Parteshit në 2021 ishin 130,134€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore

Çështja B5 - Mos verifikimi i gjendjes së pronave

Gjetja Sipas nenit 15.2 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme parashihet që veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën 20% të gjitha objekteve brenda territorit të komunës.

Komuna në vitin 2021, prej 2,471 pronave të regjistruara nuk kishte arritur të kryej verifikimin e pronave të paluajtshme.

Kjo ka ndodhur për shkak të vëllimit të punëve dhe pamundësisë për të përmbush këtë kërkesë ligjore.

Ndikimi Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në ngarkesa tatimore joadekuate.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të marrë në konsideratë plotësimin e vendeve të punës në këtë departament, dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer verifikimin e objekteve sipas dispozitave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 387,155€. Kjo vlerë përbehet Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë, taksa vjetore e biznesit, shërbimet e bartjes së mbeturinave, qiraja dhe shfrytëzimi i hapësirës publike.

Çështja B6 - Angazhimi i pamjaftueshëm për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenin 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna në PFV e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 387,155€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë dhe tokë, taksa komunale në biznese, mbeturina dhe ujë. Komuna nuk ka një plan për inkasimin e llogarive të arkëtueshme nga debitorët e saj. Si pasojë, të arkëtueshmet vazhdimisht po rriten duke shkaktuar vështirësi në inkasimin e tyre. Në vitin 2021 kemi një rritje prej 150,743€ apo 64% krahasuar me vitin paraprak (236,412€). Në këtë rritje ndikimi më i madh ishte nga tatimi në pronë, tokë si dhe në mbeturina.

Për më tej, në aneksin e bashkangjitur të PFV, vlera e prezentuar e llogarive të arkëtueshme ishte vetëm 160,192€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit dhe angazhimit jo të duhur të zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi Mos aplikimi i mekanizmave të përcaktuara me ligje dhe rregullore ndikon në rritje të vazhdueshme të këtyre llogarive, që rezulton me fonde më të vogla për arritjen e synimeve, dhe inkurajon debitorët e tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, shërbimeve dhe bartjes së mbeturinave si dhe të forcojë kontrollin e brendshëm duke vendosur mekanizma të përshtatëm për arkëtimin e të hyrave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,060,716	1,371,810	1,336,019	1,476,035	1,186,214
Grante Qeveritare - Buxheti	988,620	1,017,747	1,013,429	1,397,599	1,158,374
Financimi përmes huamarrjes	0	441	441	630	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	87,872	87,818	74,062	17,824
Të hyrat vetanake	72,096	108,135	107,504	3,744	10,016
Donacionet e jashtme	0	157,614	126,827	0	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 311,094€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga vitit i kaluar 87,872€, granti qeveritar 29,127€, të hyrave vetanake 36,040€, financimi nga huamarrja 441 si dhe donacioneve prej 157,614€.

Në vitin 2021, Komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit përfundimtar në 2021 ose 1,336,019€, me një përmirësim 11% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,060,716	1,371,810	1,336,019	1,476,035	1,186,214
Pagat dhe mëditjet	862,500	906,288	906,140	884,525	867,141
Mallrat dhe shërbimet	92,750	212,010	200,820	189,630	184,888
Komunalitë	40,000	42,400	39,377	32,204	35,955
Subvencionet dhe transferet	5,100	72,231	56,524	263,744	8,380
Investimet Kapitale	60,366	138,881	133,158	105,932	89,850

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për Paga dhe Mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 43,788€. Fillimisht me rishikim të buxhetit ishte rritur për 14,413€ ndërsa me vendime ishte rritur prej grantit qeveritar 14,714€, huamarrjes 441€ dhe 14,220€. Shpenzimet ishin 100% e buxhetit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 119,260€. Kjo rritje ishte prej të hyrave vetanake të bartura 18,051€, të hyrave vetanake 36,039€ dhe donacioneve për 65,169€. Shpenzimet ishin 95% e buxhetit;
- Buxheti final për komunalitë krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,400€, e të cilat ishin prej donacioneve. Shpenzimet ishin 93% e buxhetit;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 67,131€ e të cilat ishin prej të hyrave vetanake të bartura 1,256€ dhe donacioneve 65,875€. Shpenzimet ishin 78% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 78,515€. Kjo rritje ishte prej të hyrave vetanake të bartura 68,565€ dhe donacioneve për 9,950€. Shpenzimet ishin 96% e buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga 2021 ishin në vlerë 130,134€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksat për ushtrim të veprimtarisë, nga taksat administrative etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	72,096	72,096	130,134	79,055	57,892
Të hyrat tatimore	8,000	8,000	52,790	44,393	21,243
Të hyrat jo tatimore	64,096	64,096	77,344	34,662	36,649

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Komunës së Parteshit ka rezultuar në 7 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, një (1) është zbatuar dhe gjashtë (6) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që hartimi i PFV-ve për vitin 2021, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mangësitë e identifikuara në këtë raport. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në prezantimin e buxhetit dhe shpalosjen e saktë të llogarive të arkëtueshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Nuk kemi identifikuar gabime në PFV finale	I zbatuar

2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se pajisjet për verifikimin dhe regjistrimin e pronave futen në funksion si dhe inspektimi i objekteve për tatimit në pronë të arrijë 20%, në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Po ashtu, kryetari duhet të siguroj që zyrtarët përgjegjës janë duke i kryer detyrat dhe përgjegjësitë në lidhje me dorëzimin e faturave/aktvendimeve të subjektet afariste në kohën e duhur.	Ende nuk është bërë verifikimi i gjendjes së pronave.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.	Edhe këtë vit, anagazhimi i tyre nuk ishte bërë me procedura të prokurimit.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet Plani Vjetor për mbështetje financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për mbështetje financiare.	Ende nuk është përgatitur plani për mbështetje financiare ndaj OJQ-ve.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se toka, blerjet e pasurisë dhe përvetësimet e pasurive kapitale regjistrohen në regjistrin e pasurive.	Edhe këtë kemi identifikuar dobësi në fushën e pasurive.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë dhe të forcojë kontrollin e brendshëm duke vendosur mekanizma të përshtatëm për arkëtimin e të hyrave.	Kemi rritje të vazhdueshme të arkëtueshmeve edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim
7.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore, për të shmangur shpenzimet shtesë buxhetore.	Edhe këtë viti kemi vonesa në pagesa	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme





Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Etika Co shpk, (Fatmir Mehmeti person i autorizuar në emër të kompanisë)



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Opština Partes/Komuna e Parteshit/Municipality of Partes

POTVRDNO PISMO

O saglasnosti sa nalazima Generalnog Revizora na Izveštaju revizije za 2021 godinu kao i za sprovođenje preporuka


Za: Nacionalnu Kancelariju Revizije:


Poštovani,

Preko ovog psima, potvrđujem da:

- sam primio nacrt izveštaja Nacionalne Kancelarije Revizije o Reviziji Finansijskih Izveštaja Opštine Partes za godinu završno sa 31 decembrom 2021 (u daljem tekstu "Izveštaj");
- slažem se po svim tačkama osim u tački B3 gde treba dodati da je Opština Partes u toku 2021 godine sprovela proceduru nabavke u angažovanju ugovorača za posebne usluge kao dokaz, dostavili smo tendersku proceduru i ugovor potpisan sa ekonomskim operaterom.
- u roku od 30 dana od prijema Završnog izveštaja, dostaviti akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će uključiti vremenske rokove i osoblje koje je odgovorno za njihovo sprovođenje.

g. Dragan Petković
Gradočelnik Opštine Partes,


Datum: 01.06.2022 godine



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.